

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Clas Arredo” Sh.p.k.**

Sot, më date **03.09.2021**, ne te nenshkruarit:

**Klajdi Bengasi** lindur me 16/03/1988, shtetas shqiptar, banues ne Lushnje, identifikuar me pasaporte me Nr. BG3255086, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

-**Z. Armand Hoxha**, shtetas shqiptar, i datlindjes 09/05/1986, banues ne Lushnje, identifikuar me leternjoftim me Nr. 036032765, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “Clas Arredo” Sh.p.k. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “Clas Arredo” Sh.p.k

**Neni 2**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja “18 Tetori”, rruga “Vath Korreshi”, zona kadastrale 8572, pasuria Nr. 217/10 godine njekateshe, Lushnje.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *clasarredo@yahoo.it*  
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

**Neni 4**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Prodhim ,tregtim,eksport te mobiljeve dhe arredim te ambjenteve,etj.
- Megjitheate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**



(1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (Njeqindmije) leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Klajdi Bengasi**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **80 000** leke që përbën **80 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Armand Hoxha**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **20 000** leke që përbën **20 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asambleja e ortakëve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortakët jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

#### **Neni 7:**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statur. .

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.



Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfundimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës percaktohen ne statutin e shoqerise.

#### **Neni 9**

##### **Administrimi**

Aministratori i shoqerise emerohet **Z. Klajdi Vogli** , shtetas shqiptar, lindur me 26/03/1987 , ne Lushnje, banues ne Lushnje, mbajtes i leternjoftimit me nr.034477425 , madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar. i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe pergjegjesite e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

#### **Neni 10**

##### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gjë te tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne përfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pregatit raportin me shkrim per nxierien e rrezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per atë per kontrollet periodike te ushtruara, te cialt eshte i detyruar qe tja paraqese e ta dorëzoje ne kohe ortakëve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e te drejtes vendimore qe ka.

#### **Neni 11**

##### **Prishja-riorganizimi i shoqerise**

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise ne përputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesën IX te Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare".

#### **Neni 12**

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

#### **ORTAKET E SHOQERISE**

**Klajdi Bengasi**

*Klajdi Bengasi*  
*[Signature]*

**Armand Hoxha**

*Armand Hoxha*  
*[Signature]*